Numër: 01-375
Datë: 22.05.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Përditësohet lista e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit.

II. Aprovohet lista prej njëzet e një (21) ekspertëve të jashtëm të rinj kombëtarë dhe rajonal për verifikimin e standardeve të profesionit, në procesin e validimit dhe të akreditimit të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) si dhe në procesin e validimit dhe akreditimit për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) të IAAP, të cilët i bashkëngjiten listës së përgjithshme të ekspertëve të jashtëm, të aprovuar me vendimin e KD-së Ref.:01/65, Datë: 23/01.2025 e cila tani ka 528 ekspert.

III. Vendimit i bashkëngjitet Lista e plotë e ekspertëve të aprovuar nga KD, si shtojcë 1.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Autoriteti Kombëtar për Kualifikime ka zhvilluar procedurat për angazhimin e ekspertëve sipas listës së bashkangjitur në shtojcën 1 dhe sipas legjislacionit në fuqi lista i është propozuar për miratim Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, (AKK).

Lista e përgjithshme me ekspertë të jashtëm ndërkombëtar të akreditimit tani ka 548 ekspertë. Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura më lart si dhe rëndësinë që ka angazhimi i ekspertëve ndërkombëtarë në procesin e akreditimit, pas shqyrtimit të listës së propozuar Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK

Kopje për:

- *Arkivin e AKK-së*
- *Publikohet në web faqe.*